



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**PA1 Nr.08-343**

**26.12.2024**

**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr 01-3732/1 datë 29.07.2019, Njoftimin për ndërprerjen me transmetim të programit në radio nga Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGË SHPKNJP, nr. ynë ark.08-3937/1 datë 26.09.2024 dhe nr.ynë ark.08-4582/1 datë 07.11.2024, deklaratën numër UZP 3641/2024 datë 11.12.2024 (nr.ynë ark.08-4582/3 datë 13.12.2024) nga themeluesi/pronari i vetëm i transmetuesit dhe Konkluzionin ark.nr.02-5193/16 datë 26.12.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024 miratoi:

**Aktvendim**  
**për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve**

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGË SHPKNJP.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Arsyetim**

Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGË SHPKNJP, është posedues i lejes për transmetim në radio PA1 nr.08-126 datë 07.09.2023, që transmeton program nëpërmjet transmetuesi tokësor, në nivel lokal për zonën e Komunës së Strugës, shërbim programor radio folës-muzikor me format të përgjithshëm kryesisht informues, në gjuhën shqipe.

Më datë 26.09.2024, Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive, radio në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGA SHPKNJP, drejtuar Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) dorëzoi njoftim (nr.ynë ark.08-3937/1) se Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive radio në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGA SHPKNJP do të ndërpresë kryerjen e veprimtarisë pra me transmetim të programit në radio. Me rastin e njoftimit të cituar, Agjencia më 27.09.2024 me Shkresë nr.ynë ark.08-3937/2, e njoftoi transmetuesin në fjalë se në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) është e nevojshme të dorëzon deklaratë të noterizuar nga themeluesi/pronari i vetëm i transmetuesit, ku detyrimisht duhet të ceket se radiodifuzeri Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive radio në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGË SHPKNJP, ndërpreu me transmetim të programit në radio, si dhe datën e saktë të ndërprerjes me transmetim të programit në radio.

Më datë 07.11.2024, radiodifuzeri sërish dorëzoi njoftim (nr.ynë ark.08-4582/1) se me datë 30.08.2024 Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive radio në nivel lokal RADIO RRAPI

STRUGË SHPKNJP ka ndërprerë me transmetim të programit në radio si dhe njoftoi se do të fillohet me procedurë për likuidim ose falimentim të shoqërisë. Njëkohësisht, themeluesi i vetëm/pronari i radiodifuzionit shtroi pyetjen për mënyrën dhe formën e çertifikimit të deklaratës për ndërprerjen me transmetim të programit në radio. Për sa më sipër, Agjencia i dërgoi Njoftim (nr.y në ark 08-4582/2 datë 08.11.2024,) se deklarata mund të noterizohet në shtetin (vendin) e banimit, ku duhet të noterizohet me vulë „apostile” nga organi kompetent si dhe përkthim nga përkthyes i autorizuar gjyqësor, ose deklaratë e dhënë në gjuhën maqedone të noterizohet në ambasadën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Njëkohësisht, transmetuesi është njoftuar se me dorëzimin e deklaratës së kërkuar të noterizuar do të plotësohen kushtet ligjore, që Agjencia të marrë aktvendim për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve të – Shoqërisë për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive radio në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGË SHPKNJP.

Më datë 13.12.2024 drejtuar Agjencisë nga Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive radio në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGË SHPKNJP, është dorëzuar njoftim numër UZP 3641/2024 datë 11.12.2024 i noterizuar (nr.y në ark. 08-4582/3 datë 13.12.2024), nga themeluesi/pronari i vetëm i radiodifuzerit – Endi Bekteshi, se Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive radio në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGË SHPKNJP nga data 30.08.2024 ndërpreu me transmetim të programit në radio.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, leja për transmetim në radio ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore dhe me deklaratë me shkrim ku poseduesi njofton Agjencinë se ka ndaluar transmetimin e programeve në radio. Për përfundimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim televiziv ose në radio në bazë ligjore Këshilli nuk miraton vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse lejes i ka mbaruar afati sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi 2 të LSHMAAV).

Rrjedhimisht nga sa më sipër dhe duke pasur parasysh nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, me dorëzimin e njoftimit me shkrim të lartpërmendur nga themeluesi/pronar i vetëm i radiodifuzerit, janë plotësuar kushtet ligjore për ndalimin e vlefshmërisë së lejes sipas fuqisë ligjore, nga ku Agjencia do të fshijë transmetuesin Shoqërinë për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive radio në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGË SHPKNJP nga regjistri i transmetuesve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Njoftimin për ndalim me transmetim të programit në radio nga Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive radio në nivel lokal RADIO RRAPI STRUGË SHPKNJP, nr.y në ark. 08-3937/1 datë 26.09.2024, dhe nr.y në ark.08-4582/1 datë 07.11.2024, deklaratën numër UZP 3641/2024 datë 11.12.2024 (nr.y në ark.08-4582/3 datë 13.12.2024) nga themeluesi/pronar i vetëm i transmetuesit dhe Konkluzionin me nr.ark.02-5193/16 datë 26.12.2024, është marrë aktvendim si në dispozitiv, i cili hyn në fuqi menjëherë.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI, v.d**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.